



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETË QEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Zyra e Sekretarit të Përhershëm

Office of the Permanent Secretary

Kancelarija Stalnog Sekretara

UDHËZIM ADMINISTRATIV

NUMËR: 15/2004

DATË: 02.06.2004

LËNDA; PLOTËSIMI DHE RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT SHKOLLOR PËR KLASËN E 9-të

Në bazë të nenit 7.2 dhe 7.3 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm dhe në përputhje me nenin 5.4 pika c të Regullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë, me anë të këtij Udhëzimi Administrativ (në vazhdim UA) rregullon çështjen në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Ky UA ka për qëllim ta rregullojë mënyren e plotësimit dhe të ruajtjes së dokumentacionit shkollor për nxënësit e klasave të 9-ta.

Neni 2

Plotësimi i dokumentacionit

2.1. Për nxënësit të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të në lokalet e shkollave fillore, dokumentacioni shkollor plotësohet dhe ruhet sikur dokumentacioni për nxënësit e klasave tjera.

2.2. Për nxënësit të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të në lokalet e shkollave të mesme, dokumentacionin e plotësojnë profesorët të cilët kanë qenë të caktuar për kujdestarë klase.

2.3. Dëftesat për nxënësit nga neni 2.2, i plotëson dhe i nënshkruan kujdestari i klasës, i nënshkruan drejtori i shkollës ndërsa i vulos Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit .

Neni 3

Ruajtja e dokumentacionit

Dokumentacioni shkollor (ditari, libri amë, etj.) për nxënësit nga neni 2.1 dhe 2.2, ruhet në lokalet e shkollës në të cilën nxënësi e ka mbaruar klasën e 9-të.

Neni 4

Afati

Shpërndarja e dëftesave të klasave të nënta bëhet në afatin prej 7 ditësh nga dita e mbajtjes së Këshillit të Arsimtarëve .

Neni 5

Testi kombëtar

Nxënësit e klasave të 9-ta të cilët kanë mbetur në riprovim i nënshtrohen testit kombëtar sikur nxënësit tjerë me sukses pozitiv.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky UA hyn në fuqi me nënshkrimin e Sekretarit të Përhershëm.

Isuf Zeneli, Sekretar i Përhershëm